

AKT THEMELIMI

Sot ne dt. 16/04/2024 me cilesine e " Ortakeve Themelues ",

KRISTJAN TAMO shtetas shqiptar, i datelindjes 27/04/1988, i lindur ne ALB dhe banues ne Sarande, madhor, me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet Pasaportes me Nr. I80427059R ,leshuar ne date 08/06/2022,

ODHISEA ÇAVO shtetas shqiptar , i datelindjes 14/11/1982, i lindur ne ALB ,dhe banues ne Dermish, Bashkia Finiq , madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet Kartes se Identitetit me Nr. I21114027R, leshuar ne date 26/12/2019,

te cilet me vullnet të lire të plote e të singerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin " Per QKR", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin **S-S Summer Event** shpk.

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezqjatja, Objekti

Neni 1

Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **S-S Summer Event** shpk. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortakët themelues.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria **S-S Summer Event** shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria"). Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj. Shoqëria **S-S Summer Event** shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakët që përballojne humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne adresen:

Bashkia Finiq, Dermish, Rruga Shen-Sofia, godina nr.2.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Aktivitete argëtimi, koncerte, evente te ndryshme.

Neni 5

Kohezqjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje peridudhe kohore te papercaktuar, duke

filluar nga data e regjistrimit ne QKR.

KREU II
KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000 lekë.

Kapitali i shoqerise eshte 100,000 leke i perbere nga 2 kuota dhe zoterohet nga ortaket e shoqerise si me poshte :

1. Ortaku Themelues: **KRISTJAN TAMO** , zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 50,000 Leke, e cila perfaqeson 50 % te kapitalit te shoqerise,
2. Ortaku Themelues: **ODHISEA ÇAVO**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 50,000 Leke, e cila perfaqeson 50 % te kapitalit te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Asamblese se ortakeve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU II

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e ortakeve brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit,te ortakeve pjesmarres,per ndryshimin e statutit,zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar,shperndarjen e fitimeve,riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres,per geshtje te tjera si:emerimin dhe shkarkimin e administratoreve,te likujduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar,percaktimin e shperblimeve,perfaqesimin e shoqerise ne gjykate.

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR.

Neni 10

Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator i vetem,i cili do te jete

KRISTJAN TAMO shtetas shqiptar, i datelindjes 27/04/1988, i lindur ne ALB dhe banues ne Sarande, madhor, me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet Pasaportes me Nr. I80427059R ,leshuar ne date 08/06/2022,

Emerimi i administratorit eshte me nje afat pese vjecar me te drejte riemerimi, i cili ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se ortakut te vetem

te shoqerise.

Neni 11

Kompetencat

Administratori/et kane të gjitha kompetencat për të vepruar se bashku në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asamblese se ortakeve te shoqerise.

Administratori/et angazhojne shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratoreve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratoreve, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratori/et ose ortaku që nuk janë persona juridikë nuk u lejohe të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per çfaredo shkak, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar siç mund të jene

a.Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.

b.Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin"

c.Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008"Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil , Ligji per QKB, dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 15

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne tre ekzemplare me permbajtje dhe vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare **S-S Summer Event** shpk, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISE

ODHISEA ÇAVO



KRISTJAN TAMO

